



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor si dhe stafin tjetër administrative të gjykatave dhe prokurorive

Dhjetor 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Trajnim për Komisionet për vlerësimin e performancës në KGJK dhe KPK

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Chemonics, në vazhden e ofrimit të trajnimeve për Gjyqtarët dhe Prokurorët për qëllim të ngritjes së kapaciteteve të tyre profesionale, nga data 18 dhjetor ka realizuar punëtori dy ditore për Komisionet për vlerësimin e performancës në KGJK dhe KPK.

Ky trajnim ka ardhur si vazhdimësi e aktiviteteve të vitit të kaluar dhe punës me Komisione, prej të cilave kanë rezultuar edhe zhvillimet e kurrikulave trajnuese për anëtarët e këtyre Komisioneve brenda KGJK dhe KPK.

Gjatë trajnimit u vlerësua lartë nevoja për trajnime shtesë dhe specializim për anëtarët e Komisionit për vlerësim të performancës sidomos në vlerësimin e indikatorëve matës për shkak të vështirësive të cilat hasen gjatë zbatimit të rregullores për vlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjithashtu u diskutuan edhe ndryshimet e nevojshme legislative të akteve të brendshme, të cilat do u mundësonin Komisioneve një punë më praktike dhe të matshme.

Gjatë dy ditëve të trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe për proceset e vlerësimit dhe ankimimit, vëzhgimi dhe monitorimi në praktikë i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, paragjykimet e pavetëdijshme, sistemet për mbledhjen e informatave si dhe për çështjet e integritetit dhe etikës.

I tërë trajnimi është moderuar dhe udhëhequr nga dy ekspertët britanik z. Jonathan Caroll dhe z. Allan Cansick.

Pjesë e trajnimit ishin: Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, Kryetari i Gjykatës Supreme, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Kryetarë të Gjykatave dhe Kryeprokurorë, Gjyqtarë nga Gjykata Supreme, anëtarë të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, anëtarë të Komisionit për vlerësimin e performancës së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Inspektorë të lartë Gjyqësorë, zyrtarë të statistikave, Anëtarë të Komisioneve të përhershme në KPK, Udhëheqës të Departamenteve të Trajnimeve dhe të IT, si dhe zyrtarë ligjorë.



Takimi i Këshillit Drejtues


Më 26 dhjetor 2023, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit z. Vaton Durguti, Udhëheqës i Departamentit Special në Gjykatën e Apelit.

Temë kryesore e këtij takimi të Këshillit Drejtues ishte shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik të AD-së për vitin 2023-2025. Gjatë diskutimeve u vlerësua puna për hartimin e këtij plani dhe e veçanërisht përmbajtja e tij.

Gatë takimit Këshilli Drejtues shqyrtoi dhe miratoi edhe Planin e Integritetit të AD-së për vitin 2024-2026. Gjatë diskutimeve u vlerësua se Plani është në pajtim me kërkesën Ligjore të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit me ç'rast

e miratoi këtë plan me kërkesën që AD të angazhohet në mbikqyrjen dhe zbatimin e masave si dhe raportimin e rregullt siq kërkohet me legjislacionin në fuqi. Pjesë e agjendës së këtij takimi ishte edhe diskutimi dhe miratimi i listës së trajnuesve të përkohshëm të AD-së dhe angazhimi i tyre në zbatimin e programit trajnues për vitin 2024.

Në këtë takim, Këshilli Drejtues diskutoi edhe për çështje tjera që janë në kompetencë të punës së Këshillit, lidhur me funksionimin e Akademisë së Drejtësisë.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024



Gjatë muajit dhjetor, për 22 prokurorët e kësaj gjenerate janë realizuar gjithsej 16 sesione të trajnimit teorik dhe 11 ditë të trajnimit praktik. Sesionet e trajnimit teorik janë realizuar nga moduli: Kodi i Procedurës Penale, duke filluar nga nën moduli: “Administrimi i procedurës penale” nga i cili janë realizuar 3 sesione. Temat e shtjelluara nga ky nën modul janë: Ekzekutimi i vendimeve, marrja dhe komunikimi i vendimeve- Kapitulli XXVI dhe parashtrësat, afatet si dhe marrja dhe komunikimi i vendimeve.

Nën moduli: “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit” 2 sesione. Janë diskutuar marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, marrja e tërthortë dhe rimarrja në pyetje e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor.

Nga nën moduli: “Procedurat alternative” janë realizuar 5 sesione dhe janë trajtuar temat: kërkesa për shpalljen e personit dëshmitar

bashkëpunues, kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme, negociimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, pezullimi i përkohshëm i procedurës dhe procedura e ndërmjetësimit.

Në kuadër të nën modulit: “Provat në procedurën penale” janë realizuar 4 sesione me ç’rast janë trajtuar: provat në fazën e hetimeve, bastisjet- kontrolli - sekuestrimi i përkohshëm dhe ekspertizat, sigurimi i provave me anë të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, sigurimi i provave në veprimet fillestare të policisë.

Në kuadër të nën modulit “Roli i prokurorit në shqyrtim gjyqësor” është trajtuar vetëm 1 sesion me temë: Roli i prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit fillestar dhe 1 sesion nga nën moduli: “Shpenzimet e procedurës penale” me theks shpenzimeve të procedurës pasurore juridike.

Gjatë këtyre sesioneve prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

Trajnimi praktik për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024



Gjyqtarët e kësaj gjenerate gjithsej 28 (prej tyre një nga komuniteti boshnjak dhe një nga ai turk)

kanë vazhduar trajnimin praktik në gjykatat përkatëse të emërimit nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtar. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 20 ditë të trajnimit praktik. Në kuadër të këtij trajnimi gjyqtarët kanë asistuar në proceset gjyqësore nën mbikëqyrjen e mentorit dhe për këtë Akademia e Drejtësisë është njoftuar në baza të rregullta përmes njoftimeve, planeve dhe rasteve praktike të asistuar.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnim: Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve

Me 01 dhe 04 dhjetor 2023, në bashkëpunim me UNDP/SAEK në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, është vazhduar me sesionet e radhës nga trajnimi: Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve, paraprakisht të mbajtura me 27, 29 dhe 30 nëntor 2023. Ky trajnim është realizuar në formë hibride me pjesëmarrje fizike ndërkaq është shfrytëzuar platforma e mësimit në distancë MOODLE në kuadër të cilës pjesëmarrësit kanë pasur qasje në materialet ligjore, testet dhe rastet praktike që janë përdorur gjatë trajnimit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive lidhur me hetimin financiar dhe kthimin e aseteve, sa i përket hetimit të veprave penale të Korrupsionit nga kapitulli 33 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Shpëlarjes së parave dhe Kthimin e aseteve të fituara me vepër penale për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse

Për dy ditë me radhë trajnimi është përqendruar në ofrimin e shpjegimeve të qarta si bëhet gjurmimi i aseteve dhe organizmi i provave

elektronike, veçanërisht vëmendje iu kushtua metodës interaktive për vërtetimin e të hyrave ilegale. Gjithashtu u trajtua ndihma e ndërsjellë juridike dhe cilët janë mekanizmat për konfiskim të aseteve.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të aplikojnë drejtpërdrejtë përmes Platformës së mësimit në distancë të Akademisë së Drejtësisë, teknikat sa i përket hetimit të veprave penale të Korrupsionit nga kapitulli 33 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Shpëlarjes së parave dhe Kthimin e aseteve të fituara me vepër penale. Të gjithë të pranishmit e përfunduan trajnimin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm.

Në fund, trajnuesit falënderuan pjesëmarrësit dhe angazhim konstruktiv, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për organizmin e trajnimit. Këtë trajnim e vijuan 16 pjesëmarrës. Prej tyre 4 prokuror, 6 bashkëpunëtorë profesional, 1 zyrtar ligjor 4 zyrtarë policor dhe 1 zyrtar nga ATK.



Program i Specializuar i Trajnimit-Krimi Kibernetik dhe Kriptoalutat

Më 05-06 Dhjetor 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimi Kibernetik dhe kriptoalutat – Sesioni III”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të njoftohen për së afërmi me Krimi kibernetik si vepër penale në legjislacionin e brendshëm, procedurën dhe praktikën në lidhje me provat elektronike, Bitcoin 101 – Adresat, çelësat dhe transaksionet.

Fokus të theksuar në këtë trajnim ishin sfidat që hasin prokurorët dhe gjyqtarët për Kriptoalutat që tashmë është një temë shumë e spikatur dhe e diskutueshme edhe në mesin e profesionistëve të sektorit privat dhe publik që janë të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave.

Kriptoaluta më e mirënjohur, Bitcoin ka ngjallur shumë interesim posaçërisht për faktin se mediat vazhdojnë të merren me një numër të hetimeve dhe të ndjekjeve me profil të lartë në

tërë botën. Pjesëmarrësit janë njoftuar me bashkëpunimin vendor ndërinstitucional kur autoritetet publike që janë të angazhuara në hetimet financiare, siç janë organet e rendit, prokurorët publikë, Njësitë e Inteligjencës Financiare (NJIF) dhe autoritetet tatimore i kombinojnë ekspertizat e tyre, punojnë së bashku dhe i këmbëjnë informatat dhe në këtë mënyrë arrijnë rezultatet më të mira. Për më tepër, ekziston një vetëdijësim dhe dëshirë në rritje që palët private si bankat, agjencitë e patundshmërisë dhe provajderët e shërbimeve të tjera profesionale do të mundnin dhe do të duhej të jepnin kontribut të çmuar në hetimet financiare.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjithësejt 15 pjesëmarrës. Prej tyre 6 gjyqtarë 3 prokurorët, kryesisht të nivelit themelor si dhe 3 bashkëpunëtorë profesional dhe 1 zyrtarë ligjor si dhe 1 ekspert nga PRSK.



Trajnim: Përmbledhja e specifikave të TIK-ut, lincencimit dhe të drejtave të pronësisë



Me 05-06 Dhjetor 2023, është realizuar trajnimin me temë: “Përmbledhje e specifikave të industrisë së TIK-ut, licencimit dhe të drejtave të pronësisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me trajtimin e teknologjisë dhe impaktit të saj në sistemin e drejtësisë veçanërisht në fushën e të drejtës elektronike komerciale si përgjegjësia ligjore.

Gjatë trajnimit u diskutua lidhur me Mbrojtjen e të Dhënave dhe Privatësinë; Tregtinë Elektronike; Pronësinë Intelektuale me fokus në sferën digjitale si dhe licencimin e të drejtave pronësore intelektuale

U diskutuan disa nga sfidat kryesore që hasen në fushën e TIK-ut siç janë: transaksionet digjitale, nënshkrimet digjitale, vulat digjitale, pagesat digjitale, kontratat digjitale, zgjidhja e mosmarrëveshjeve lidhur me e-tregtinë me fokus në zgjidhjet alternative të ofruara, mbrojtja e konsumuarit nga sfidat online, të drejtat e subjekteve të të dhënave, parimet e përpunimit të të dhënave personale, sfidat kyçe lidhur me mbrojtjen e të dhënave (Inteligjenca Artificiale; Big Data; Surveillance); mbrojtja e pronësisë intelektuale online, funksionimi i të drejtave të autorit në botën digjitale, sfidat kyçe lidhur me të drejtat e autorit online (Hiperlidhjet; Makina e Kërkimit; Shpërndarja (P2P), Pronësia e Domenëve, Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të Domenëve, Licencimi i Pronësisë Intelektuale si dhe llojet e kontratave të licencimit të PI-së.

Përveç pjesës teorike, u kushtua rëndësi e veçantë diskutimeve të ndryshme dhe interaktive me pjesëmarrësit. Përdorimi i ushtrimeve dhe studimeve të rasteve reale, të adaptuara në kontekstin e ligjit vendas, ndihmuan pjesëmarrësit të zbatojnë konceptet teorike në situata praktike. Rrjedhimisht, disa konkluzione dhe rekomandime të përgjithshme u nxorën nga ky trajnim dhe janë si në vijim:

Nuk ka njohuri të mjaftueshme dhe as raste praktike të mjaftueshme, andaj AD të ofrojë më shumë tryeza diskutimi, seminare ose mundësi të komunikimit më të shpeshtë lidhur me këto problematika;

Nevoja për ndryshime të legjislacionit ekzistues për të adresuar sfidat e reja ligjore, siç është tregtia elektronike e cila nuk ka ligj të posaçëm andaj dhe krijon paqartësi;

Pjesëmarrësit sugjeruan ndarjen e tre temave (e-commerce, pronë intelektuale dhe licencimi, dhe mbrojtja e të dhënave) në module të veçanta trajnimi për të lehtësuar kuptimin e tyre, pasi secila nga temat është komplekse dhe e veçantë nga njëra-tjetra. Kjo qasje lejon një eksplorim më të qëndrueshëm dhe në thellësi të secilës temë, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe nevojën për kuptim të plotë.

Shtimin e një moduli trajnimi të posaçëmpër të adresuar sfidat dhe rregullat e mediave online, duke ofruar njohuri të thella për pjesëmarrësit në këtë fushë, duke qenë se disa nga sfidat më të shpeshta që lidhen me fushën e TIK kanë qenë nga mediat online, rrjetet sociale dhe gazetatat.

Përfitues të trajnimit ishin 6 pjesëmarrës. Prej tyre 3 gjyqtarë (2 nga Gjykata Komerciale dhe 1 nga Gjykata Themelore e Pejës) dhe 3 bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata Komerciale.

Trajnim: Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe atyre të arbitrazhit

Më 07 Dhjetor 2023, është realizuar trajnimi me temë “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe atyre të arbitrazhit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Përmbartimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës.

Trajnimi ishte fokusuar në rolin e formave alternative të zgjidhjes së kontesteve me theks të Arbitrazhit, në radhë të parë për sigurinë juridike dhe mundësinë e tërheqjes së investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik e më pas u diskutua për procesin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit, përmbartimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunalet e Arbitrazhit brenda dhe jashtë Kosovës.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin e studimit dhe analizimit të një rasti praktik përmes të cilit u sqaruan aspekte të rëndësishme

që gjyqtarët hasin gjatë procedurës së njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit, zbatimin e drejtë të bazës ligjore të arbitrazhit si dhe unifikimin e praktikës së njohjes së arbitrazhit.

Gjatë diskutimeve u tha se baza juridike e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit buron pikërisht nga autonomia e vullnetit të palëve dhe parimi i konsensualitetit për të shmangur juridiksionin e gjykatave të rregullta nacionale dhe kontraktimi i kompetencës së gjykatës së arbitrazhit.

Metodologjia e zbatuar ishin e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 22 gjyqtarë. Prej tyre 7 gjyqtarë nga Gjykata Komerciale, 2 nga Dhoma e Posaçme Gjykatës Supreme dhe 13 nga niveli Themelor i Gjykatave.



Trajnim: Krimet mjedisore, korniza ligjore vendore kombëtare dhe e BE-së



teti
De-
tar i

Më 11 dhe 12 dhjetor 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë dhe në mbështetje të Akademisë ERA, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta realizuan në Tiranë trajnimin me temë: “Krimet mjedisore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira të dy vendeve duke përfshirë edhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian sa i përket hetimit dhe gjyqimit të krimeve mjedisore për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve përkatëse.

Në hapjen e këtij trajnimi ishte prezent Drejtori i Shkollës së Magjistraturës së Shqipërisë, z. Arben Rakipi, i cili konfirmoj përkushtimin e Akademisë ERA për të ofruar trajnimin për gjyqtarët e dy vendeve në çështjet që kanë të bëjnë me Krimet mjedisore.

Në ditën e parë Krimet mjedisore u trajtuan nga perspektiva e Bashkimit Evropian nga Profesori i angazhuar nga Akademia ERA si Michael Faure, Profesor i së Drejtës Krahasuese dhe Ndërkombëtare të Mjedisit, Universiteti i Matrihtit, Grazia Maria Vagliasindi, Profesor i Asociuar i Juridikut, Universiteti i Katania si dhe Remus Jurj, Profesor i Asociuar, Universi-

Konstancës, njëherësh ish prokuror dhe anëtarë i Rrjetit Evropian të Prokurorëve për Mjedisin.

Në fillim trajnimi u përqendruan në kornizën ligjore aktuale të Bashkimit Evropian për krimin mjedisor me theks te Direktiva për krimin mjedisor dhe mbrojtja e mjedisit përmes të drejtës penale në BE. Fokus i veçantë i kësaj direktive ishin elementet kryesore, detyrimet kryesore dhe llojet kryesore të kundërvajtjeve, ndërlidhjes ndërmjet zbatimit penal dhe atij administrativ si dhe zhvillimi i të drejtës penale mjedisore në BE dhe shtetet anëtare të saj.

Rol të rëndësishëm gjatë këtij trajnimi iu dha Politikës së BE-së dhe propozimeve legislative për direktivë të re si dhe udhëzimeve për të luftuar krimin mjedisor për shkak të ndikimit ekonomik, pasojave dhe mjeteve për të luftuar krimin mjedisor. Posaçërisht u fokusua te sfondi i flukseve financiare të lidhura me krimin mjedisor ndërkombëtar në rastet e trafikimit të kafshëve të egra, prerjeve të paligjshme, tregtia e drurit, me ç ‘rast u prezantua edhe Direktiva Evropiane kundër pastrimit të parave dhe mbështetja e institucioneve financiare në adresimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe rolit të agjencive dhe organeve të BE-së për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal si EUROPOL, EUROJUST, FRONTEX, EMCDDA, etj si dhe të Komisionit Evropian si DG Just, DG Taxud, DG Mare.

Gjatë trajnimit u theksua edhe roli i *acquis* të BE-së dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal dhe veçanërisht zbatimi gjyqësor i BE-së i ligjit penal mjedisor dhe praktikës gjyqësore të GJED-së.

Në fund të ditës së parë dhe në vazhdim edhe në ditën e dytë u trajtuan krimet mjedisore nga perspektiva Kosovare nga gjyqtari i Gjykatës Supreme z. Afrim Shala si dhe perspektiva e jurisprudencës së Shqipërisë e cila u elaborua në mënyrë të hollësishme nga Elvana Çiçolli, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Administrativ në Tiranë.

Gjyqtarët nga dy vendet patën rastin e diskutimit për veçantitë e ligjit dhe praktikën gjyqësore shqiptare dhe kosovare duke u përqendruar në gjykimin e rasteve që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit, hetimin dhe akuzimin e kryerësve të veprave penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

Me rastin e këtij trajnimi u ofrua edhe raste studimor që kishin të bënin me trafikimin e kafshëve të egra dhe peshkimin e paligjshëm me ç'rast gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës patën rastin e diskutimit për veçantitë e rasteve dhe të ofrojnë zgjidhjet e tyre ligjore dhe njëkohësisht të ndajnë perspektivat e tyre për rastet konkrete.

Këtë trajnim e vijuan 15 gjyqtarë nga Kosova nga të gjitha instancat dhe regjionet e Kosovës si dhe 8 gjyqtarë dhe prokurorë nga Shqipëria.



Program i Specializuar i Trajnimit-Korrupsioni zyrtarë dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare-Sesioni III

Më 13 Dhjetor 2023 në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni III”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët të njoftohen për së afërmi me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare për vendosjen e drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve në procedurë gjyqësore.

Trajnimi u përqëndrua në shpjegime të hollësishme sa i përket elementeve të veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare me theks te dashja. Në vijim edhe për çështjen e realizimit apo mos realizimit të dëmit apo përfitimit, vlerësimi i provave bindëse dhe rrethanore. Të gjitha këto çështje u elaboruan edhe përmes një rasti praktik i cili u diskutua

edhe nga pjesëmarrësit dhe perspektiva e tyre për rastin konkret.

Gjatë trajnimit janë paraqitur problemet që në vazhdimësi kanë paraqitur definimin e personave që hynë në kategorinë e personave zyrtar, karakteristikat e këtyre veprave penale dhe njëkohësisht duke analizuar dispozitat ligjore përkitazi me kualifikimin juridik të veprave penale.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 10 pjesëmarrës. Prej tyre 2 gjyqtarë dhe 5 prokurorë kryesisht të nivelit themelor si dhe 3 bashkëpunëtorë profesional nga PSRK.



Trajnim online: Aspektet më të rëndësishme të Sekuestrimit\Konfiskimit të pasurive, sipas sistemit ligjor në Shqipëri dhe Kosovë


Më 20 dhjetor 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin regional "Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor përmes forcimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e kthimit të pasurive", implementuar nga AIRE Centre dhe RAI Sekretariat, mbështetur nga Qeveria Britanike, realizuan seminarin online përmes platformes zoom me teme "Aspektet më të rëndësishme të Sekuestrimit\Konfiskimit të pasurive, sipas sistemit ligjor në Shqipëri dhe Kosovë.

Qëllimi i këtij seminari ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me aspektet kritike të konfiskimit të pasurive, duke ofruar njohuri të vlefshme dhe duke nxitur diskutime mbi standardet ndërkombëtare, procedurat

hetimore dhe kompetencat gjyqësore në lidhje me proceset e konfiskimit të pasurive.

Gjatë këtij seminari u trajtua Konfiskimi i pasurisë, ligje të veçanta dhe të zakonshme për konfiskimin e pronës nën optikën e standardeve ndërkombëtare, veçanërisht konfiskimi i zgjeruar dhe mosndëshkueshmëria" si dhe "Dispozitat për sekuestrimin/konfiskimet në KP, KPP dhe konfiskimi i zgjeruar në Kosovë. Metodologjia e seminarit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar, prokuror nga Kosova dhe Shqipëria.



Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Trajnim: Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor



Me 01 Dhjetor 2023, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës - CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitet të Drejtësisë) është realizuar trajnimi me temë: “Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të stafit administrativ gjyqësor dhe lidhur me sfidat që lidhen me performancë, duke përfshirë ato që lidhen me përdorimin e Sistemit Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (CMIS), dhe për të identifikuar zgjidhjet e mundshme bazuar në metodologjinë e CEPEJ.

Gjatë trajnimit është vënë në pah diskutimi i bazuar në statistika reale të nxjerra nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve (SMIL), sfidat e hasura në gjykata si dhe identifikimi dhe shmangia e vonesave. Pjesë e këtij trajnimi ishte edhe përmirësimi i aspekteve organizative të punës për të rritur efikasitetin me theks te përpunimi i lëndëve të vjetra në mënyrë efikase

dhe përgatitjet paragjyqësore, diskutimi për analizimin e lëndëve të prapambetura (veprimet e fundit të ndërmarra në secilin rast dhe identifikimi i hapave të mbetur për zgjidhje efikase të lëndëve) si dhe diskutimi për kalendaret procedural, afatet e paracaktuara, koordinimi me avokatë dhe ekspertë.

Trajnimi u fokusua në parimet e menaxhimit të rrjedhës së rasteve, format e menaxhimit të cilat mundësojnë efikasitetin e gjykatës.

Gjithashtu vëmendje e veçantë i ’u kushtua edhe kontrollimit të shtyrjeve të rasteve që ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin jo vetëm të gjyqtarit individual por edhe gjykatës në përgjithësi si dhe besimit të publikut. Më tej trajnimi u fokusua edhe në kontributin e stafit administrativ në menaxhimin e dosjeve duke ofruar zgjidhjen përmes kontrollimit kohë pas kohe të lëndëve, afateve dhe veprimeve tjera procedurale që janë ndërmarrë me qëllim që të zbatojnë në praktikë këto teknika të cilat janë dëshmuar për menaxhim të suksesshëm të rasteve në vendet e punës.

Përfitues të trajnimit ishin 13 punonjës nga stafi administrativ i gjykatave (bashkëp. profesional, administratore, shef i zyrës për menaxhim të lëndëve, referentë) nga të gjitha regjionet.



Trajnim: Procedura paraprake dhe avokimi-Mentorim për bashkëpunëtorët profesional

Më 12 – 13 Dhjetor 2023, në bashkëpunim me Iniciativën për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI) i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Madhe dhe Ambasada e Mbretërisë së Madhe në Prishtinë, është realizuar trajnimin për bashkëpunëtorë profesional me temë “Procedura paraprake dhe avokimi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional lidhur me zhvillimin e aftësive të avokimit, prezantimin e shkathtësive, teknikave dhe koncepteve të reja, duke mësuar nga përvojat e njëri tjetrit.

Për dy ditë me radhë është diskutuar procedura paraprake dhe avokimi, pandershmëria, lirimi me kusht, ryshfeti, ndërtimi dhe hartimi i akuzës/aktakuzës, konspiracioni, veprat penale kundër integritetit seksual.

Vlen të theksohet se i gjithë trajnimi gjatë këtyre dy ditëve është zhvilluar në formë të simulimit të rasteve praktike, ku të gjithë pjesëmarrësit patën rastin të punonin në grupe, të hartonin aktakuza dhe aktgjykime me ç’rast pjesëmarrësit patën mundësinë që nga ekspertët

ndërkombëtar të marrin perspektivat e tyre për shkresat e ndryshme në procedurë penale.



Të gjithë pjesëmarrësit e përfunduan debatin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm, pasi të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në bisedë. Në fund ekspertët falënderuan pjesëmarrësit për angazhim konstruktiv që patën gjatë këtyre dy ditëve, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për realizimin e këtij trajnimi dhe bashkëpunimin e ndërsjellët që ka me (WBROLI) Iniciativa për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Madhe dhe Ambasada e Mbretërisë së Madhe në Prishtinë.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike, duke prezantuar seancat e mentorimit që janë zhvilluar gjatë gjithë trajnimit.


Përfitues të këtij trajnimi kanë qenë 17 bashkëpunëtorë profesional të gjykatave dhe prokurorive. Prej tyre 6 nga gjykatat e nivelit themelor dhe 10 nga PRSK dhe 1 nga niveli themelor i prokurorisë.





Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve






Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660